

## QYTETET E KOSOVËS DHE PËRFSHIRJA E TYRE NË LUFTËRA GJATË SHEKUJVE XVI-XVIII

Isuf AHMETI  
Universiteti " Iliria"  
Prishtinë

Punim studimor

**Përmbajtja e shkurtër:** Në këtë studim theks të veçantë u kemi kushtuar luftërave austro-osmane gjatë shekullit XVII, rrjedhojat e të cilave kanë lënë gjurmë të thella në zhvillimin e jetës së qyteteve të Kosovës. Një faktor me rëndësi në këtë kuadër paraqesin sidomos kryengritjet shqiptare kundër osmanëve gjatë shekujve XVII-XVIII. Kryengritjet e kësaj kohe mund të konsiderohen si shprehje e pakënaqësisë së shqiptarëve me sistemin tatimor dhe me keqpërdorimet e administratës osmane. Intensiteti i kryengritjeve shqiptare u shtua dhe u intensifikua edhe më shumë gjatë këtyre shekujve. Ndër të gjitha dalloheshin qytetet e Kaçanikut, Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës. Kryengritjet kishin përfshirë sidomos trevat malore të Kelmendit, treva këto të cilat shtriheshin deri te Mitrovica dhe Novi Pazari. Perandoria Osmane përdori metoda të ndryshme që t'i qetësonte Kelmendasit, duke u bërë atyre edhe disa koncesione, mirëpo, nuk pati sukses.

Edhe pse luftërat në fjalë kanë lënë pasoja të mëdha përveç Novobërdës, qytet që u shkatërrua pothuaj tërësisht, qytetet e tjera, si: Peja, Vuçitërna, Prizreni (si qendra administrative), Prishtina dhe më vonë Gjilani e Gjakova, morën veten dhe ecën krahas qyteteve të tjera të përparuara të Ballkanit.

Periodha nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII shënon një etapë të re me kushte historike shumë të vështira për popullin shqiptar. Shoqëria shqiptare kishte humbur një pjesë të konsiderueshme të forcave të gjalla njerëzore dhe ishte zhveshur deri diku nga shtresat e zejta-

rëve, tregtarëve dhe të inteligjencies. Pushtimi, me pasojat e veta negative, goditi rëndë forcat prodhuese dhe ndërpreu procesin e zhvillimit organik e të pavarur ekonomik, politik e shoqëror, duke e kthyer vendin disa shekuj prapa, në një shkallë zhvillimi të kapërcyer me kohë. Nga ana tjetër, dukuritë e reja ekonomike e politike që lindën dhe vepruan pas pushtimit, siç qenë përgjithësimi i regjimit të timareve si njësi me ekonomi natyrale të veçuara, luftërat dhe ekspeditat ushtarake të vazhdueshme për forcimin e pushtetit osman, vënia në shërbim të armikut e klasës feudale shqiptare, copëzimi i madh politik-administrativ etj., u bënë shkaqet kryesore që ngadalësuan ritmet e zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit, që vonuan ripërtëritjen e forcave prodhuese gjatë shek. XVI dhe përçuan një kulturë dhe ideologji të huaj.<sup>1</sup>

Sipas të dhënave historike, dihet se osmanët e kishin pushtuar Prizrenin definitivisht më 21 qershor 1455. Duhet theksuar se po atë vit, në fund të prillit 1455, Isa begu rrethoi Novobërdën dhe kërkoi prej komandantit të fortesës që ta dorëzonte kalanë pa luftë. Mirëpo, kur ky refuzoi, niset personalisht Sulltan Mehmed Fatihu [1451-1481] me pjesë të tjera të ushtrisë dhe pas një rrethimi që zgjati 40 ditë e pushtoi Novobërdën më 1 qershor 1455. Pas Novobërdës, osmanët pushtuan dy kala të vogla, Prizrenas dhe Prilepas, kurse më 21 qershor 1455 ra edhe Prizreni në duart e turqve.<sup>2</sup> Si pushtues i Prizrenit merret komandanti i njohur i akinxhijve [vullnetarë të organizuar në njësi ushtarake që depërtonin nëpër vendet e papushtuara dhe plaçkitnin e shkaktonin çrregullim] Ahmed beg Evrenoszade, i cili më vonë pushtoi edhe Shkodrën.<sup>3</sup> Ky ka ndërtuar në Prizren një xhami, ka pasur dyqanet e veta që përmenden në vakufnamenë e Kukli begut të vitit 1538.

Sulltan Fatihu qëndroi në Kosovë deri në shtator të këtij viti. Aty vizitoi edhe varrin e Sulltan Muratit I dhe ndërtoi një tyrbe.<sup>4</sup> Me pushtimin e Prizrenit, osmanët ndërtuan një xhami provizore për të falë namazin ngadhënjimtar, ashtu siç bënë në të gjitha qytetet e tjera të pushtuara rishtazi. Kjo xhami provizore (namazgâh) ndodhej në rrugën

<sup>1</sup> S. Pulaha, *Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XVIII (Dokumente osmane)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1978, f. 3.

<sup>2</sup> Franz Babinger, *Muhamed der Erober und seine Zeit*, München, 1953, f. 131-134.

<sup>3</sup> Kjo informatë është sipas kronikave turke, krahaso: F. Babinger, *Muhamed der Erober und seine Zeit*, f. 131-134.

<sup>4</sup> F. Babinger, *Muhamed der Erober und seine Zeit*, f. 134.

e Gjakovës, në të dalë nga Prizreni. Ka gjasë që Sulltan Fatihu të ketë vizituar personalisht Prizrenin ose me rastin e pushtimit, ose ndonjë muaj më vonë, sepse, me urdhrin apo mbikëqyrjen e tij, u shndërrua në xhami kisha Sv. Bogorodica Levishka.<sup>5</sup>

Që kur Kosova kishte rënë nën osmanët shqiptarët kurrë nuk ndejnë duarkryq, mirëpo vazhdimisht organizonin kryengritje të ndryshme kundër këtij pushtuesi. Kryengritjet e kësaj kohe mund të konsiderohen si shprehje e pakënaqësisë së shqiptarëve me sistemin tatimor dhe me keqpërdorimet e administratës turke.<sup>6</sup>

Është me interes të vihet në pah përmbajtja e një fermi nga 28. I. 1584, i cili u është dërguar sanxhakbejlerëve të Dukagjinit, të Vushtrrisë, të Prizrenit dhe të Shkupit si dhe kadilerëve të kadillëqeve përkatëse. Sipas këtij urdhri të sulltanit, titullarët e lartpërmendur duhej të merrnin këto masa: t'i ndihmojnë çaushit të lartë, i cili ishte dërguar nga Porta e Lartë, për shuarjen e kryengritjeve që kishin shpërthyer në ato vise. Por, në qoftë se kryengritësit e kapur janë spahinj, atëherë të burgosen, e nëse nuk janë spahinj të dënohen në bazë të sheriatit. Kjo e dhënë tregon qartë se pakënaqësia ishte rritur aq shumë, madje edhe tek raja myslimane dhe përfaqësuesit e klasës askere, tek spahinjtë, sa që kryengritja e kishte kapluar gjithë Kosovën.<sup>7</sup>

Sipas një dokumenti osman të vitit 1560, beu i Dukagjinit, Baki beu, në një letër tregon se si një prijës i cubave kryengritës me emrin Pjetër Bogdani nga fshati Dush i livasë së mësipërme i plaçkiste tregtarët nëpër rrugë dhe ua merrte mallin. Ky plaçkitës u kap nga një vojvodë me emrin Hysein, të cilin me këtë rast e shpërblyen duke ia dhënë një timar.<sup>8</sup>

Po ashtu, kemi edhe një dokument që flet lidhur me kryengritjet shqiptare kundër osmanëve, siç vijon: Një urdhër nga Sulltani beut të Dukagjinit, më 26 shkurt 1565, ku thuhet se një numër i madh fshatarësh nga fshatrat Bërdhet, Rap, Ribë, Arst, Rilë, Itballë, Kaçinar, Klumert, Dush, Fand i Vogël, Plakëz, Mirditë e Vogël, Mirditë e Madhe, Kolçin, Qerret, Mamish, Ujmisht, Suroj të Sanxhakut të Dukagjinit

<sup>5</sup> H. Kaleshi, *Shënime nga e kaluëmja e Prizrenit gjatë periodës turke*, Rev. Përparimi, nr. 7-8, Prishtinë, 1961, f. 498.

<sup>6</sup> J. Drançolli, *Kryengritja e Kelmendit kundër sistemit sundues turk*, gazeta e përditshme Rilindja, Nr. 7696/XXXVI, Prishtinë, 1980, f. 13.

<sup>7</sup> S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 483-484.

<sup>8</sup> Mühimme defteri, nr. 4, dokumenti 133.

janë ngritur në kryengritje kundër osmanëve. Sulltani urdhëron beun e Dukagjinit që sa më parë këta njerëz të shkatërrohen dhe t'u merret e gjithë pasuria që kanë, kurse fëmijët e tyre të shndërrohen në robër. Sulltani më pastaj shton edhe këtë: të kesh kujdes që të mos shpëtojnë kryengritësit dhe të shkaktojnë trazira të mëdha, të ruhesh nga çdo veprim që është në kundërshtim me urdhrin tim si dhe nga çdo veprim i pamatur. Në të kundërtën, pasojat do t'i bartësh ti.<sup>9</sup> Pasi nuk pati sukses, beu i Dukagjinit i dërgon letër Sulltanit dhe kërkon që të ndërmerrej një aksion për ndëshkimin e tyre, sepse shumë sish kishin ngritur krye. Sulltani ia kthen përgjigjen beut të Dukagjinit dhe e sugjeron të angazhojë ushtrinë dhe t'i kapë gratë dhe fëmijët e kryengritësve, në mënyrë që kryengritësit të dorëzohen dhe t'u jepet dënimi i merituar e pastaj gratë dhe fëmijët e tyre të lirohen, mirëpo me një kujdes të madh në mënyrë që të mos bjerë në grackë ndokush i pafaj. Për të gjitha këto përgjegjësia është në anën tuaj.<sup>10</sup>

Në dokumentin e radhës të 16 shtatorit të vitit 1565 Sulltani nga Porta e Lartë e kishte urdhëruar nëpërmjet një letre Ahmet beun e Elbasanit që kryengritësit e fshatrave Ujmisht dhe Suroj të Dukagjinit të asgjësoheshin sa më parë, sepse këta kishin ngritur krye dhe kishin vrarë vojvodët e sanxhakbeut. Për asgjësimin e këtyre kryengritësve Sulltani kishte dërguar edhe dyqind jeniçerë të oborrit të vet.<sup>11</sup>

Sipas dokumentit osman të 26 marsit 1566, kryengritësit e Dukagjinit kanë ndërprerë qarkullimin rrugor dhe kanë grabitur karvanët tregtarë në Prizren, Shkodër dhe Pejë. Sulltani kërkon nga beu i Dukagjinit që këta persona të kapen sa më parë dhe të futen në burg, ndërkaq malli t'u kthehet tregtarëve, kurse neve na i dërgoni dosjet e tyre me të gjitha të dhënat.<sup>12</sup> Po ashtu, në dokumentin osman të 30 nëntorit 1568 thuhet se kryengritësit e fshatit Fandi i Vogël kanë ngritur krye dhe kundërshtojnë pagimin e taksës së xhizjes. Sulltani urdhëron beun e Dukagjinit që këta kryengritës të kapen dhe të dënohen sipas ligjit të sheriatit, po që se dalin fajtor të ekzekutohen në mënyrë që t'u jepet mësim të tjerëve, kurse të tjerët që nuk mund të

<sup>9</sup> Mühimme defteri, nr. 6, dokumenti 361.

<sup>10</sup> Mühimme defteri, nr. 6, dokumenti 366.

<sup>11</sup> Mühimme defteri, nr. 5, dokumenti 110.

<sup>12</sup> Mühimme defteri, nr. 5, dokumenti 480.

kapen dhe tregojnë kokëfortësi t'u merren emrat dhe të na i dërgoni neve.<sup>13</sup>

Me fjalë të tjera, pjesëmarrja e klasës askere në kryengritjet popullore tregon se sistemi timar kishte filluar të përjetojë krizë dhe se në atë kohë, kah fundi i shek. XVI, sistemi timar kishte filluar të shthurret, e në gji të tij kishte filluar të lindë sistemi i ri, rendi çifligar.

Është për të vënë në pah se kryengritjet e turmave popullore e kishin kapluar gjithë Perandorinë Osmane në gjysmën e dytë të shek. XVI, në mënyrë të veçantë kryengritjet e shqiptarëve, të të gjitha kategorive, ishin më të dalluara kudo në Perandori, në Rumeli dhe Anadoll. Shqiptarët në burimet osmane konsideroheshin si popullsi e parehatshme apo më liridashës.<sup>14</sup> Intensiteti i kryengritjeve popullore shqiptare u shtua edhe më shumë gjatë shek. XVII.

Gjatë shekujve XVI-XVII, kur Perandoria Osmane filloi të dobësohej, Kelmendasit,<sup>15</sup> bashkë me fiset e tjera të malësive u ngritën kundër pushtuesit osman. Që në shekullin XVI Malësinë shqiptare e kishte përfshirë zjarri i kryengritjeve të armatosura kundër sundimit të huaj. Ndër të gjithë dalloheshin Kelmendasit për shkak të pozitës strategjike-gjeografike që kishin. Perandoria Osmane përdori metoda të ndryshme që t'i qetësonte Kelmendasit, duke u bërë atyre edhe disa koncesione. "Kelmendasit e krishterë nga feja duhet t'i paguajnë sanxhakut një mijë [1000] akçe haraç dhe një mijë akçe ispenxhe, por ata përjashtoheshin nga ashri, avarizi i divanit<sup>16\*</sup>, si dhe nga tatimet e tjera", thuhet në një dokument.<sup>17</sup> Ata pushtetit i obligohen që, si derben-

<sup>13</sup> Mühimme defteri, nr. 7, dokumenti 920.

<sup>14</sup> S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 489.

<sup>15</sup> Kelmendasit para ardhjes së pushtuesve osmanë në viset tona, banonin në Malësinë e Madhe, ku jeton edhe sot, një pjesë e fisit të tyre.

\* **Divani:** ishte institucioni më i lartë dhe më i rëndësishëm për të gjitha punët shtetërore. Në divan merrnin pjesë veziri i madh /sadriazemi/, kazaskeri, defterdarët etj. Merrej me punët politike, administrative, ushtarake, gjyqësore dhe financiare. Divani i shqyrtonte ankesat dhe akuzat. Ishte i hapur për të gjithë nënshtetasit e Perandorisë, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare, klasore dhe gjinore. Me Divanin udhëhiqte sulltani ose sadriazemi. Gjatë fushatave luftarake sulltani me bashkëpunëtorë të vet Divanin e mbante në vendin ku gjendeshin. Krahaso: S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 284-285.

<sup>17</sup> B. Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore i malisorskih plemena*, Knj. II, Sarajevo, 1954, f. 19-79.

xhinj\* të kujdesen për sigurimin e ngushticave të rrugëve, duke i liruar nga obligimet e tjera. Edhe pse doli të kishte disa suksese gjatë shekujve XV e XVI, në fillim të shek. XVII filluan trazirat dhe nga viset e Malësisë së Madhe u dëbuan spahinjtë osmanë, kurse malësorët mbetën fshatarë të lirë.

Përprjekjet e shqiptarëve për çlirim në këto vite u shfaqën dhe u zhvilluan në dy drejtime kryesore: Të nxisnin koalicionin e shteteve evropiane që të merrte seriozisht çështjen e luftës për dëbimin e pushtuesit osman nga Ballkani, dhe e dyta, të bashkonin krerët e popujve kryengritës të Ballkanit për të trajtuar problemin e çlirimit nga sundimi osman me shtetet e koalicionit evropian në kushte barazie, ashtu siç kishin vepruar sidomos Kuvendet Shqiptare. Krerët kryesorë shqiptarë, duke bërë udhëtime e vizita nëpër oborret evropiane, duke shkruar letra e duke shtruar projekte për luftën çlirimtare, morën të njëjtat masa dhe ndoqën po atë strategji që kishin përpunuar më parë në Kuvendet Shqiptare.

Shembulli i luftës shekullore çlirimtare të shqiptarëve, duke vazhduar traditën e epokës së Skënderbeut, kishte frymëzuar në Ballkan, me ato masa që lejonin rrethanat, luftën çlirimtare. Duke iu referuar luftërave të shek. XVI Frang Bardhi shprehet me këto fjalë: Gjithashtu, asnjë komb në Evropë, që gjendet nën zgjedhën turke, nuk ka mundur të çojë krye kundër tij dhe të qëndrojë 100 vjet në kryengritje në mbrojtje e sulme të mëdha kundër gjendjes barbare, sikundër vazhdojnë sot disa popuj të këtij kombi shqiptar.<sup>18</sup>

\* **Derbenxhinjtë** jepnin në mënyrë të prerë [caktuar] në vit 1000 akçe-haraç [tatim, xhizja-haraç] dhe sanxhakbeut me të prerë [caktuar] 1000 akçe ispenxhe, kurse ushurin [oşür = të dhjetat] dhe taksat e tjera nuk i jepnin, janë të liruar dhe të falur nga të gjitha detyrimet e divanit [avariz-i divaniye]; mbikëqyrnin dhe ruanin rrugët, grykat etj. Duke pasur parasysh të gjithë atë që u tha më lart, mund të përfundohet se raja ishte ajo kategori e shoqërisë osmane mbi supet e së cilës mbështetej klasa shfrytëzuese-klasa askere. Në sistemin timar, deri sa ishte në formën e saj të padeformuar, pozita e rajës ishte e durueshme, ishte e kënaqshme, nëse krahasohet me atë të bujkrobërve të Evropës Perëndimore. Por, nga gjysma e dytë e shekullit XVI, kur ky sistem filloi të shturet, edhe pozita reale e rajës filloi të keqësohet, e në shekullin XVII madje u bë e padurueshme. Krahaso: S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 409; H. Hadžibegić, *Kanun-nama sultana Sulejmana, zakonodavča*, GZM BiH, Sarajevo, 1949-1950, f. 295-381.

<sup>18</sup> *Relacion i Frang Bardhit mbi Pukën, 1637 në Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*, përgatitur nga I. Zamputi, vëllimi II, Tiranë, 1965, dok. Nr. 24, f. 87.

Gjatë Luftës Habsburgo-osmane të viteve 1593-1606, komandantët osmanë u ankuan se spahinjët e tyre ishin të pafuqishëm para musketa-rëve austriakë dhe kërkuan që të formoheshin reparte këmbësorësh të armatosur me pushkë.<sup>19</sup> Megjithatë, s'ka si të mos arrish në përfundim se kishte një rënie të përgjithshme të standardeve, bazuar në faktin që qeverisja, në pjesën më të madhe të niveleve, po bëhej gjithnjë e më pak efikase dhe më grabitëse.

Në zanafillë të shumicës së këtyre të këqijave ishte paraja. Sistemi legal, për shembull, u bë mjaft i korruptuar pas gjysmës së shekullit XVI.<sup>20</sup> Sjelljet e nëpunësve rajonalë janë përshkruar haptas në Dekretin e Drejtësisë të shpallur nga sulltani më 1609, ku thuhej: "Ju nuk po i vizitoni provincat për të kryer detyrën. Përkundrazi, ju po silleni vërdallë, duke ia rrëmbyer popullit paratë në mënyrë të paligjshme".<sup>21</sup> Sipas një raporti nga Prizreni, më 1652, taksa të reja të rënda ishin vënë mbi katolikët.<sup>22</sup>

Disa nga këto ngjarje, që shkaktuan reprezalje ishin kryengritjet lokale të argjipeshkvijve në Kosovë ose afër territorit të Kosovës; porse jo të gjitha ato kishin seriozisht si qëllim edhe përmbysjen e sundimit osman. Gjithashtu, kishte pasur revolta edhe për shkak të taksave të larta, ose protesta kundër nëpunësve jashtëzakonisht të ashpër, qëllimi i të cilëve ishte rikthimi i praktikave të mëparshme zyrtare osmane.<sup>23</sup>

Nuk ka kurrfarë arsyes të supozohet se vëllazëria e plaçkitësve të quajtur Bilejiç dhe Tuvaçeviç, të cilët i sulmonin karvanët raguzanë, në afërsi të Novobërdës dhe Kaçanikut, në fillim të shekullit XVI, bie fjalla, të konsiderohen se kishin të bënin me luftën çlirimtare.<sup>24</sup>

Në të njëjtën mënyrë, historianët bashkëkohorë shqiptarë flasin për një kryengritje në trevën e Pejës, të udhëhequr nga Pjetër Bogdani më 1560, mirëpo gjithë ajo që dimë për këtë kryengritje është se ai e kishte plaçkitur një karvan, kishte vrarë disa tregtarë dhe pastaj ishte

<sup>19</sup> H. Inalcik, *Military and Fiscal Transformation in the Ottoman Empire, 1600-1700*, Archivum ottomanicum, vëll. 6, London, 1980, f. 288.

<sup>20</sup> Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë, 2001, f. 121.

<sup>21</sup> Ibid.

<sup>22</sup> J. Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 275.

<sup>23</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 123.

<sup>24</sup> G. Elezović, *Turski spomenici*, Nr. 1, vëll. 1, Beograd, 1940, 337-347.

kapur dhe ishte dënuar me vdekje.<sup>25</sup> Një revoltë tjetër që ndodhi në një vis të Kosovës Perëndimore më 1585 ka mundësi të ishte organizuar me qëllim që të rikthehej shkalla e mëparshme e taksave.<sup>26</sup>

Në pranverën e vitit 1638 banorët e Pejës dhe të Vushtrrisë dhe të qyteteve të tjera, nëpërmjet një peticioni iu ankuan sulltanit se Kelmendi së bashku me fiset e tjera shqiptare dhe malazeze po i plaçkitnin karvanët që vinin nga Raguza dhe Sarajeva, duke vrarë përafërsisht 50 tregtarë në vit dhe duke vjedhur 20-30 mijë dhen.<sup>27</sup>

Lufta osmano-habsburge e viteve 1683-99 shënoi një kthesë në historinë e Evropës. Kjo luftë ka një rëndësi të veçantë në historinë e Kosovës. Në vjeshtën e vitit 1689, një armatë e vogël perandorake pushtoi Kosovën, dëboi forcat lokale osmane dhe vendosi kontrollin austriak në tërë këtë rajon. Shumë nga banorët e Kosovës shprehën besnikërinë ndaj perandorit austriak; disa ndër ta madje u shkruan edhe si trupa ndihmëse. Ndërkaq, në ditët e para të vitit 1690 austriakët u tërhoqën me nxitim dhe një ushtri e përzier osmano-tatare iu vërsul Kosovës, duke bërë plaçkitje dhe vrasje të mëdha. Më pas, më 1690, austriakët u detyruan të tërhiqeshin edhe më drejt veriut, duke braktisur më parë shtabin e tyre në Nish, e më tej, pas një rrethimi të shkurtër, u larguan edhe nga qyteti kyç fortesë i Beogradit. Me tërheqjen e austriakëve, u largua edhe një numër refugjatësh; nga fundi i vitit mijëra sish gjendeshin në një gjendje tërësisht të mjerë në mes të Hungarisë. Me ta kishte ikur edhe patriarku i Pejës Arsenije III Çërnojeviq.<sup>28</sup>

Siç ishte zakoni në kohë të luftës, në Perandorinë Osmane ishin vënë taksa të reja dhe ishte rritur çmimi i bukës; katolikët e Janjevës e kishin çuar seriozisht nëpër mend largimin nga Kosova që më 1683, kurse regjistri i taksave i Vushtrrisë i vitit 1686 tregon se një e treta e paguesve të xhizjes\* të një viti më parë tashmë kishte ikur.<sup>29</sup> Në shumë pjesë të Perandorisë Osmane kishin pllakosur uria, murtaja si dhe tra-

<sup>25</sup> S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 481-482.

<sup>26</sup> Mühimme Defterleri, nr. 49, dokumenti 344; nr. 53, dok. 242; nr. 58, dok. 234; nr. 61, dok. 92; nr. 64, dok. 349.

<sup>27</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 124.

<sup>28</sup> Ibid, f. 144.

\* **Xhizje**- Taksë për kokë të meshkujve të mitur. Popullsia e krishterë, e cila pranonte të paguajë xhizje, ishte nën mbrojtjen e shtetit. Krahaso: S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 396.

<sup>29</sup> J. Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*, Beograd, 1950, f. 377.

zira të dhunshme shoqërore. Një tablo e gjallë e kushteve të kësaj kohe shihet më së miri në letrën e shkruar nga Pjetër Bogdani në maj të vitit 1688. Nën pushtetin e Jegenit, shkruante ai, kishat u mbyllën, priftërinjtë e shpërndanë dhe populli mori arratinë. Ai vetë, i shoqëruar nga një turmë e madhe besimtarësh, iku në male dhe shtrat i tij u bë bora. Kjo dëshmon se në çfarë shtate kaotike ndodhej rajoni i Kosovës për pothuajse më shumë se një vit para invadimit austriak.<sup>30</sup> Pas disa muajsh thuajse anarkie në rajonin e Kosovës, Jegeni më në fund u dëbua dhe qe i shtrënguar që të kërkonte strehim tek pashai i Pejës, Mahmut Mahmutbegolli, të cilin e kishte mik. Pastaj, Mahmutbegolli mori një urdhër të prerë nga sulltani, ku thuhej: Koka për ne, malli i tij për ty. Koka e Jegenit u dorëzua në Stamboll më 19 mars 1689.<sup>31</sup>

Në shtatorin e vitit 1688 austriakët e kishin futur në dorë fortesën e rëndësishme të Beogradit, e verën tjetër edhe Nishin, që ua bënte të mundur të depërtonin në tërë Ballkanin Qendror. Në gjysmën e tetorit të vitit 1689 Badeni dërgoi një forcë prej 5 mijë ushtarësh, duke përfshirë edhe dy regjimente të kalorësisë dhe një kompani ushtarësh të quajtur rashkas në jug, në Kosovë.<sup>32</sup> Prijësi i kësaj ushtrie ishte konti Eneo Pikolomini, me prejardhje nga një familje e famshme italiane, që habsburgasve u kishte dhënë disa komandantë të lavdishëm. Që në pranverën e atij viti Pikolomini iu afrua mjaft Kosovës, duke përparuar drejt jugut nëpër Serbi të Mesme dhe mbërriti në Novi- Pazar nga ku dëboi pashain e Pejës, Mahmutbegollin. Por, qëllimi i ekspeditës së tij ushtarake në tetor e kapërceu cakun e një sulmi. Siç shpjegonte edhe vetë Badeni në udhëzimet që i janë dërguar trashëgimtarit të Pikolomini pas një muaji, synimi strategjik ishte që të pushtohej një territor i gjerë ndërmjet Kosovës dhe bregut Adriatik, në mënyrë që të izolohej plotësisht territori osman nga Bosnja; dhe në qoftë se trupat austriake nuk do të mjaftonin për këtë detyrë, atëherë synohej që së paku Kosova të mbahej nën kontroll, duke i zotëruar të gjitha grykat dhe fortifikatat.<sup>33</sup> Ardhja Pikolominit në Kosovë ishte tërësisht pozitive, kështu që Mahmutbegolli, i cili i kishte dalë përpara me 10 mijë ushtarë, u zbraps menjëherë. Shumë prej ushtarëve të tij ishin ortodoksë, prandaj pjesa më e madhe e tyre siç duket dezertoi. Sipas një raporti të një oficeri të

<sup>30</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 147.

<sup>31</sup> Ibid.

<sup>32</sup> Ibid, f. 148.

<sup>33</sup> Ibid.

Pikolominit, myslimanët vendës kishin ikur para arritjes së austriakëve.<sup>34</sup>

Një raport i hershëm i kësaj ekspedite ushtarake, që mbështetet në dokumentet origjinale, pohon se para se të arrinte Pikolomini në Prishtinë, banorët vendës ortodoksë i kishin dërguar atij nderimet e tyre nëpërmjet peshkopëve të tyre.<sup>35</sup> Argjipeshkvi katolik nxitoi po ashtu që të përshëndetej me trupat austriake që po përparonin. Në një letër të shkruar dy muaj më vonë nga nipi i tij, prifti Gjin Bogdani, e shpjegon arsyen e vet: Kur armatat ngadhënjyese të Perandorit tonë arritën papritmas në këto anë, ai shkoi personalisht që t'i takojë dhe për ta frenuar arrogancën e ushtrisë, në mënyrë që ata të mos i fillonin plaçkitjet apo masakrimin e katolikëve. Ai pati sukses të plotë në këtë.<sup>36</sup>

Qyteti i Prishtinës u pushtua pa ndonjë rezistencë. Popullata normale e Prishtinës kapte shifrën prej 15 mijë banorësh, ndërsa shumica e saj ishte myslimane. Shumë nga ta ikën, ashtu siç dëshmojnë edhe raportet e sipërpërmendura. Por, një raport i hershëm thotë: Në Prishtinë 5 mijë arnautë\*, pasi iu shporrën zgjedhës osmane iu betuan austriakëve për besnikërinë. Pastaj Pikolomini sulmoi garnizonet osmane të Novobërdës dhe Kaçanikut. Novobërda u dorëzua, kurse Kaçaniku u pushtua më 23 tetor.<sup>37</sup> Ai i dërgoi një raport Badenit në fund të tetorit ku thoshte se priste që patriarku ortodoks, së bashku me disa krerë të këtij territori, të vinin ta takonin brenda disa ditësh. Siç do të shohim, ai kishte dërguar një oficer në Pejë për ta ftuar patriarkun Arsenije.<sup>38</sup>

Ndërkohë, me të mësuar se Mahmutbegolli ishte tërhequr në Shkup, Pikolomini e ndoqi atë dhe e sulmoi armatën e tij të fushuar jashtë qyteti. Armata e Mahmutbegollit përbëhej prej 6 mijë vetash, kryesisht “rashkas dhe shqiptarë”; këto forca u shpartalluan tërësisht dhe 2 mijë prej tyre mbetën të vvarë.<sup>39</sup> Shumë qerre përplot me plaçka lufte dhe

<sup>34</sup> *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë [1675-1699]*, vëll. IV, [ed. nga I. Zamputi dhe S. Pulaha], Akademia e Shkencave e Shqipërisë [Instituti i Historisë], Tiranë, 1990, f. 229.

<sup>35</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 149.

<sup>36</sup> *Ibid.*

\* **Arnaut** – ishte term i zakonshëm i përdorur nga autorë të Perëndimit për shqiptarët, zakonisht myslimanë, veçanërisht për ata që shërbenin si ushtarë të ushtrisë osmane.

<sup>37</sup> *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë [1675-1699]*, vëll. IV, f. 258.

<sup>38</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 151.

<sup>39</sup> *Ibid.*

me ushqime i shtuan rezervat ushqimore të austriakëve. Shkupi pa dyshim ishte qyteti më i madh dhe më i pasur i rajonit; porse pasi e pa qartë se nuk mund ta mbronte atë, Pikolomini ia vuri flakën qytetit dhe u kthye me armatën e tij në Kosovë. Këtu në jug të Prishtinës, në qytetin e vogël Lypjan, e ndau armatën e tij në tri grupe, për t'i kontrolluar të gjitha hyrjet kryesore në Kosovë. Duke marrë një repart të vogël më vete, ai pastaj e vazhdoi marshimin në perëndim drejt Prizrenit, ku mbërriti më 6 nëntor.<sup>40</sup>

Me ta mbërritën edhe disa mijëra serbë e shqiptarë katolikë. Se ishin 20.000, siç thuhet në disa burime, duhet marrë me rezervë të madhe ngase aq katolikë nuk kishte në këto anë. Atëherë në trevën e Prizrenit dhe në Shqipërinë e Epërme të krishterët e armatosur depërtuan në vendbanimet myslimane dhe plaçkitën pasuritë e tyre.<sup>41</sup>

Autori i një kronike arabe, Tahir Efendia, thotë se të pafetë atëherë kanë vrarë shumicën e popullatës së Prizrenit dhe kanë rrëzuar shumë xhami, kështu që në Prizren nuk kishin mbetur më shumë se dhjetë shtëpi myslimane dhe se shumë janë sëmure nga murtaja dhe kanë vdekur. Nga 20.000 shtëpi myslimane, sa kishte pasur Prizreni, kishin mbetur vetëm 16.<sup>42</sup>

Historiani Kamilo Kontarini, raporti i të cilit u botua më 1710, që me sa duket ishte mbështetur në dokumentet origjinale, përshkruan mbërritjen e Pikolominit në Prizren me këto fjalë: Afër Prizrenit, teksa po i afrohej qytetit, i dolën përpara banorët për ta pritur me brohoritje festive: ishin gjithsej 5 mijë veta të udhëhequr nga argjipeshkvi i tyre, duke mbajtur flamurin me kryqin e shenjtë. Në shenjë homazhi, ata e pritën Pikolominin me tri batore pushkësh.<sup>43</sup>

Suksesi diplomatik i Pikolominit në Prizren e kurorëzoi ngadhënjimin e tij ushtarak në Shkup, por ai nuk jetoi aq sa ta gëzonte atë. Para se të arrinte në Prizren, atij i doli një xhungë nën sqetull, që në të vërtetë ishte një gungë tumori, dhe kështu më 9 nëntor vdiq. Pjetër Bogdani, i cili bëri homazhet dhe ritet e fundit të varrimit, vazhdoi punën e tij, por pas pak kohësh edhe ai u infektua; atë e çuan në Prishtinë

<sup>40</sup> J. Радонић, *Римска курија и јужнословенске земље*, f. 402.

<sup>41</sup> J. Томич, *Десет година из историје српског народа и цркве под Турцима (1683-93)*, Београд, 1902, f. 44.

<sup>42</sup> Хасан Калеси-Исмаил Ерен, *ПРИЗРЕНЦ МАХМУД-ПАША РОТУЛ, ЊЕГОВЕ ЗАДУЖБИНЕ И ВАКУФНАМА*, Старине Косова, књ. VI-VII, Приштина, 1972-73, f. 23

<sup>43</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 151.

për ta mjekuar te mjekët më të mirë austriakë. Megjithatë, ai vdiq në Prishtinë më 6 dhjetor, kurse vajin e bekuar e të shenjtë atij ia dha një jezuit gjerman.

Sipas emisarit të Papës në Vjenë, Holshtajni nuk qe në gjendje t'i përmbahej marrëveshjes me shqiptarët, siç kishte bërë Pikolomini. Ai filloi t'iu vinte taksa tepër të larta atyre dhe t'i pushkatonte ata që i rezistonin. Si pasojë e kësaj, nga fundi i vitit prej 20 mijë shqiptarëve që i kishte mbledhur Pikolomini, mbetën vetëm 3 mijë.<sup>44</sup>

Sulmi i parë i osmanëve filloi në fund të dhjetorit. Tre mijë osmanë iu vërsulën Kosovës dhe ua vunë flakën shumë fshatrave në skajin juglindor të këtij territori. Para kësaj ngjarjeje, Holshtajni thirri më 22 dhjetor Këshillin e luftës në Prishtinë, në të cilin u mor vendimi që të mbeteshin në Kosovë, me kusht që forcat austriake të përqendroheshin. Çfarëdo plani që të ketë bërë ai, ndërkaq, u prish më 30 dhjetor nga lajmi se kalaja që kontrollonte Grykën e Kaçanikut tashti ishte rrethuar; kishte vetëm njëqind luftëtarë të armatosur me pushkë, kurse armata osmane po afrohej gjithnjë e më tepër.

Studiuesi Tomić ka të drejtë kur thotë se në dhjetëvjetëshin e para-fundit të shek. XVII në qytetet e viseve jugperëndimore Prizren, Gjakovë e Pejë ka mbizotëruar popullata myslimane.<sup>45</sup> Atëherë fillon sundimi i, siç i quan ai, Mahmudbegoviçëve të Pejës, në disa burime edhe Brenoviçët ose Brankoviçët, të cilët gjatë gjithë periudhës osmane do të luajnë rol të rëndësishëm në historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë Veriore.

Ndërkohë, Holshtajni i dha urdhër një oficeri të tij, kolonelit Shtraser, që me një repart të vogël forcash të nisej nga jugu për t'u bashkuar me 500 luftëtarë të regjimentit të Pikolominit, të cilët do të niseshin nga Prizreni; të bashkuar, ata do t'i shkonin në ndihmë Kaçanikut. Shtraser kishte 1300 trupa austriake [900 kalorës dhe 400 këmbësorë], si dhe 1500 rashkas dhe shqiptarë.<sup>46</sup> Ato u nisën nga Prishtina më 1 janar 1690; të nesërmen, Shtraseri do t'i çonte ata në një disfatë katastrofike, kështu që brenda disa orësh austriakët do të braktisin Kosovën.

<sup>44</sup> Ibid.

<sup>45</sup> J. Томич, *Десет година из историје српског народа и цркве под Турцима [1683-93]*, f. 40, 151-52.

<sup>46</sup> S. Külçe, *Osmanli tarihinde Arnavutluk*, botuar me Firzovik toplantisi ve merutiyet, Smyrna, 1944, f. 105.

Gjatë muajit prill oficeri venedikas në Mal të Zi raportonte se të gjitha fjalët e përhapura gjoja për ripushtimin e austriakëve ishin të rreme; ai po ashtu shkruante: Kosova, e shkatërruar nga të dy ushtritë, tashti është e shkretuar; në fshat nuk mund të gjeje frymë njeriu.<sup>47</sup> Një anëtar i shtabit të Veteranit bëri një analizë edhe më faktike, por fare pak më të zymtë. Ai shkruante se të gjitha fshatrat në rrethin e Vushtrrisë dhe të Trepçës ishin të shkreta, si edhe shumica e 360 fshatrave të tjera në rajonin e Prishtinës. Mirëpo, shifrat e tij të hollësishme për viset e tjera, përfshirë Novobërdën, Suharekën, Prizrenin, Gjakovën e Pejën, japin një numër të përgjithshëm prej 671 fshatrash, të gjitha ende të populluara. Kishte ngjarë ajo që pritej në atë kohë: ana verilindore e Kosovës ishte treva nga e cila banorët mund të kenë ikur më lehtë drejt Nishit, që ishte territor nën sundimin austriak.<sup>48</sup>

Në vitin 1690 shpërtheu një murtajë që bëri kërdrinë, ndërsa asgjësimi i rezervave të ushqimit i shtrëngoi njerëzit të hanin mish kuajsh dhe qensh.<sup>49</sup> Nga fundi i marsit të po atij viti sulltani shpalli një ferman [urdhër] për ndalimin e vrasjes së mëtejme të rajës dhe u premtoi mbrojtje të gjithë atyre të cilët nuk kishin marrë pjesë aktive në forcat habsburgase.

Në fund të shkurtit të vitit 1690, sulltani nga Porta e Lartë i lëshon urdhrin serasqerit të ushtarëve të islamit, vezir Halil pashës, në mënyrë që t'i shtypë kryengritësit e Gashit, Rrazës, (Rasta?), (Podakirës?), Pukës, Kthellës, Selitës, Reçit Lurës, Fandit e Mirditës në sanxhakët e Dukagjinit dhe të Ohrit, sepse janë lidhur me austriakët, të cilët synojnë të zbresin në Kosovë.<sup>50</sup>

Një zyrtar austriak shkoi deri aty sa të deklaronte më 1724 se rashkasit, në të vërtetë më me qejf donin të jetonin nën sundimin osman sesa nën atë austriak, sepse autoritetet osmane e dënonin vrasësin vetëm me gjobitje, ndërsa të territorin habsburgas vrasësit pushkatoheshin.<sup>51</sup>

Gjendja e përgjithshme e katolikëve në Kosovë, që nga rivendosja e sundimit osman, më 1690, nuk ishte e mirë. Priftërinjtë e tyre ose kishin marrë arratinë, si për shembull Raspasani, ose ishin vrarë, si bie

<sup>47</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 151.

<sup>48</sup> Ibid.

<sup>49</sup> S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 126.

<sup>50</sup> Mühimme defteri, nr. 99, dokumenti 72.

<sup>51</sup> N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, f. 151.

fjala Gjin Bogdani; në periudhën menjëherë pas invadimit austriak vetëm njëri nga ta mbeti në tërë Kosovën; ai mbeti gjallë vetëm për arsye se ia dhuroi Mahmutbegollit tërë pronën e vet, madje edhe shtëpinë.

Lufta osmane-austriake 1683-1690 ka lënë pasoja të rënda në Kosovë. Kur austriakët pushtuan Prizrenin, të krishterët e armatosur kanë bërë një varg vrasjesh, torturash dhe plaçkitjesh midis popullsisë myslimane. Sipas një burimi osman, austriakët dhe aleatët e tyre të krishterë vranë shumicën e popullsisë myslimane, shkatërruan shumë monumente fetare dhe kulturo-arsimore e shoqërore, kurse një pjesë e popullsisë vdiq nga murtaja. Mirëpo, kur osmanët, tatarët dhe Mahmut pashë Begolli i Pejës me shqiptarët myslimanë i dëbuan austriakët, ata në të njëjtën mënyrë filluan ta torturojnë popullsinë e krishterë. Kjo është koha kur nëpër qytetet e Kosovës dominon popullsia myslimane.<sup>52</sup>

Prishtina [Prishtina] zihet në gojë në Luftën austro-osmane [1689]. Aty ishin përqendruar ushtritë austriake. Gjykuar sipas raporteve austriake, në atë kohë në krahinën e Prishtinës kishte 360 fshatra të mëdha e të vogla. Një pjesë e tyre ishin djegur.<sup>53</sup>

Mirëpo, Prishtina pas luftërave austro-osmane [1683-1699], të cilat i dhanë grusht të rëndë edhe asaj, së shpejti i shëroi plagët e luftës dhe filloi të përtërihet dhe të bëhet qytet me rëndësi ekonomike dhe me popullsi të shumtë.<sup>54</sup>

Lëvizja antiosmane në shekullin XVII mori përpjesëtime më të mëdha. Sidomos në kohën e luftërave austro-osmane [1683-1699]. Në burime shkruan se në këto luftëra morën pjesë në anën e ushtrisë austriake kundër ushtrisë osmane edhe shqiptarët e tjerë. Në këtë kohë lëvizja dhe kryengritjet kundër pushtetit osman përfshinë edhe trevën e Vushtrrisë. Pas katastrofës së ushtrisë austriake në Kaçanik në vitin 1690, një numër i konsiderueshëm i popullsisë serbe, ngase nuk ishte në gjendje të priste përsëri pushtetin osman, u shpërngul për në veri përtej Savës dhe Danubit në Vojvodinë. Kjo ishte koha e ashtuquajturës dyndjes së madhe serbe, e cila në histori duhet të quhet dyndja e

<sup>52</sup> Хасан Калеш-Истајл Ерен, *Призренац Махмуд-Паша Ротул, његове задужбине и вакуфнама*, f. 61.

<sup>53</sup> S. Rizaj, *Prishtina gjatë shekujve XVII-XX [1912]*, Instituti Albanologjik [Gjurmime Albanologjike], nr. 18-1988, Prishtinë, 1989, f. 90.

<sup>54</sup> Ibid.

popullsisë së këtyre vendeve në veri të Savës dhe të Danubit në Vojvodinë në vitin 1690. Në këtë dyndje, përveç serbëve janë shpërngulur shqiptarë, maqedonas, etj. Në kohën e luftërave austro-osmane 1716-1718, numri i shqiptarëve që u shpërngulën bashkë me serbët ishte më i madh. Afër Mitrovicës së Sremit janë themeluar fshatra të tëra me shqiptarë, si Nikinci, Hërtaç, etj.<sup>55</sup>

Në burimet austriake, shihet se qytetet dhe fshatrat e Kosovës pësuan dëme të mëdha. Një numër i fshatrave në rrethinat e Trepçës, Vushtrrisë dhe Prishtinës u shkatërruan e shumë prej tyre mbetën të shkreta.<sup>56</sup> Në kohën e luftërave austro-turke dhe kryengritjeve ekonomia e këtyre vendeve pati pasoja të rënda, sidomos bujqësia dhe blegtoria. Shumë toka mbeten të zbrazëta. Në fillim të vitit 1690 nga sëmundjet e ndryshme, e sidomos nga murtaja, vdiqën shumë njerëz.<sup>57</sup>

Për pasojat e murtajës ka lënë shënime edhe përfaqësuesi i Republikës Vllahë, i cili në rrugë për në Stamboll kaloi nëpër Novi-Pazar, Banjskë dhe Vushtri.<sup>58</sup>

Në kohën e luftërave austro-osmane, kryengritjeve dhe lëvizjeve të ndryshme antiturke u shkaktuan dyndje, migrime dhe emigrime të popullsisë, të cilat patën pasoja të rënda për ekonominë e vendit. Në këtë kohë, përveç rënies së bujqësisë, blegtorisë dhe tregtisë, në disa miniera u ndërpre edhe puna.

Kemi theksuar se Prizreni, sikurse edhe qytetet e tjera të Kosovës, pësoi një disfatë të tmerrshme gjatë luftës osmane-austriake 1683-1690. Shumica e popullsisë u vra, u shkatërruan shumë xhami, kështu që në Prizren mbetën vetëm 10 shtëpi. Është fakt se një pjesë e madhe e popullsisë vdiq edhe nga sëmundjet. Madje murtaja mori edhe vetë Pikolominin e Pjetër Bogdanin.<sup>59</sup> Me vdekjen e Pikolominit, më 9 nëntor 1689, komandën e mori Hercog Holshtajn, i cili u nis me 3 mijë ve-

<sup>55</sup> E. Pllana, *Vuçitërna me rrethinë nën sundimin osman shekulli XV-XVII [Ekonomia, marrëdhëniet shoqërore, popullsia dhe rezistenca kundër pushtetit osman]*, Vjetari i Arkivit të Kosovës, Nr. XVI-XVII, Prishtinë, 1983, f. 43.

<sup>56</sup> M. Kostić, *O postanku i značenju tzv. "Invitatorije" Leopolda I Upućeno balkanskim narodima od 6. aprila 1690 I*. E SAW knj. Beograd, 1951, f. 16; E. Pllana, *Vuçitërna me rrethinë nën sundimin osman shekulli XV-XVII*, f. 43.

<sup>57</sup> Rajko V. Veselinović, *Srbija e Makedonija pod turskom Vlašću u drugoj polovini XVII veka*, Novi Sad, 1960, f. 33.

<sup>58</sup> Hamdija Kreševljaković, *Hanovi i Karavansaraji u BiH*, "Djelo" knj. VIII, Sarajevo, 1957, f. 52.

<sup>59</sup> J. Radonić, *Rimska kurija i Južnoslovenske zemlje*, Beograd, 1950, f. 402.

të në Lumë. Kur nuk gjeti asnjë njeri, sepse të gjithë kishin ikur, nga mllef i ai i kishte djegur të gjitha fshatrat. E, kur u tërhoq ushtria austriake nga këto vende, ndihmësit e tyre vendës u shpartalluan dhe në Prizren, Gjakovë e Pejë hyri Mahmud pashë Begolli, i cili filloi terrorin e kundërt. Kështu kishte ndodhur edhe nga fundi i shekullit XVIII, kur një pjesë e popullsisë së këtyre krahinave emigron me Arsenijen IV Jovanoviç-Shakabeta.<sup>60</sup>

Në një raport osman të vitit 1738 vihet në dukje se Janjeva, Novobërda, Prishtina dhe Vushtrria ishin shkatërruar në tërësi, kurse popullata e tyre ose kishte ikur ose ishte vrarë. Burimet katolike konfirmojnë se shumica prej tyre ishin vrarë, një numër ishin syrgjynosur, kurse një numër edhe më i madh i burrave dhe i grave ishin marrë si skllevër. Shumë ngjarje të periudhës pas vitit 1690 ishin përsëritur edhe këtë herë. Më pas, më 1740, u shpall një urdhër që i thërriste fshatarët e krishterë të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Kundër fiseve malësore u ndërmorën disa ekspedita ndëshkuese; një ndër këto fise, pjesë e fisit ortodoks malëz Vasojeviç, u shpërngul me dhunë në Kosovën Perëndimore, kurse patriarku i ri, me origjinë greke, u vendos përsëri në Pejë.<sup>61</sup>

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII e deri më 1836, do me thënë në periudhën e familjes së Rrotullëve, në Prizren paraqitet një element i ri etnik – Cincarët. Ata vijnë në Prizren prej Maqedonisë, Epirit dhe Thesalisë, me ftesë të pashallarëve të Prizrenit nga familja Rrotulli. Me profesion kanë qenë muratorë dhe shumë të aftë në ndërtimin e xhamive. Kjo shihet edhe nga fakti se numri i tyre përmendet vazhdimisht në statistikat e Prizrenit.<sup>62</sup>

Si në shumë pjesë të tjera të Perandorisë Osmane, në shekullin XVIII pushtetin e vërtetë në rajonin e Kosovës e kishin disa njerëz nga familjet e njohura vendëse, të cilat kishin ushtritë e tyre private të për-krahësve të vet. Dinastitë vendëse kishin një traditë mjaft të gjatë; familja Mahmutbegolli, bie fjala [e njohur si Begolli], kishte pasur sundimtarë të Pejës që nga shekulli XVI, duke pretenduar se e kishte prejardhjen nga familja e Dukagjinëve e Shqipërisë mesjetare.<sup>63</sup> Ndër fa-

<sup>60</sup> H. Kaleshi, *Shënime nga e kaluemja e Prizrenit gjatë periodës turke*, f. 509.

<sup>61</sup> D. Slijepčević, *Istorija srpske pravoslavne crkve*, vëll. I, Munich, 1962-6, f. 384.

<sup>62</sup> P. Kostić, *Cincarska naseobina u Prizrenu i borba oko crkve Sv. Spasa*, Bratstvo. XIX, Beograd, 1925, f. 296.

<sup>63</sup> S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, f. 297-8.

miljet e tjera të rëndësishme ishte ajo e Rrotullëve që ka sunduar në Prizren prej vitit 1770 deri më 1836, kurse familja Gjinolli, anëtarët e së cilës kanë sunduar në Prishtinë dhe në Gjilan, u bë aq e fuqishme në fillim të shekullit XIX sa që pjesëtarët e saj u quajtën sundimtarë të dytë të Kosovës, pas sulltanit.<sup>64</sup>

As luftërat austro-osmane në fund të shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII nuk e ndërprejnë kontinuitetin shqiptar në këto qytete.<sup>65</sup> Gjatë shekullit XVIII duken shenjat e mëtejme të dobësimit të Perandorisë Osmane në pikëpamje ushtarake-ekonomike dhe politike. Shkaqet e kësaj, siç i përmendëm më lart, qenë disfatat në luftëra me Rusinë dhe Austrinë. Rrjedhojat e tyre krijuan etapën e re në zgjidhjen e Çështjes Lindore, në të cilën politika evropiane përpiqej që gjithnjë e më tepër të ndikojë në zhvillimin e situatës në Perandorinë Osmane, sidomos në Ballkan. Franca dhe Anglia dëshironin që të mbahet Perandoria Osmane, në mënyrë që t'i mbanin privilegjet tregtare, të cilat i gëzonin me anë të kapitulacioneve dhe në këtë mënyrë do të vazhdonin më tej robërimin ekonomik në epokën e kapitalizmit dhe kolonializimit. Po kështu këtë politikë ua diktonte edhe situata politike, sepse mbajtja e një gjendjeje të tillë në Perandorinë Osmane pengonte depërtimin e interesave të Rusisë dhe Austrisë. Sukseset e kësaj politike u manifestuan sidomos pas sukseseve ushtarake të fundit të shekullit XVIII, kur edhe filloi kriza në Perandorinë Osmane, e cila u zhvillua gjatë shekullit XVIII sidomos pas mosukseseve në luftërat me Austrinë dhe Rusinë.<sup>66</sup>

Kur filloi dobësimi i forcës ushtarake të Perandorisë Osmane, rezistenca e popujve të robëruar të Ballkanit u bë gjithnjë e më e fuqishme dhe popujt ballkanikë bënë kthesën vendimtare në zhvillimin e mëtejme të së ashtuquajturës Çështje Lindore, në saje të rritjes së lëvizjes çlirimtare.<sup>67</sup>

Luftërat që u ndërmorën në gjysmën e dytë të shekullit XVIII i treguan Portës së Lartë se me organizimin e prapambetur dhe me pajisjet e vjetruara të ushtrisë së saj nuk mund t'i ruajë posedimet e saja.

<sup>64</sup> Đ. Mikić, *Društvene i ekonomske prilike kosovskih Srba u XIX i početkom XX (od čifčijstva do bankarstva)*, Beograd, 1988, f. 15-16.

<sup>65</sup> M. Tërnavë, *Studime për mesjetën*, Pejë, 2000, f. 128-129.

<sup>66</sup> Miroslav Đorđević, *Oslobodilački rat srpskih ustanika 1804-1806*, Beograd, 1967, f. 18-19.

<sup>67</sup> B. Shehu, *Rrethanat ekonomiko-sociale në Shqipëri*, Gjurmime Albanologjike, nr. VII-1977, Prishtinë, 1978, f. 78.

Te dobësimi i forcës ushtarake atë e solli edhe kriza e sistemit feudal, e cila ia dobësoi edhe forcën financiare.<sup>68</sup>

## **CITIES OF KOSOVO AND THEIR INVOLVEMENT IN WARS OF XVI - XVIII CENTURIES**

### **Summary**

In this study, we have specially emphasized Austro - Ottoman wars, during the XVII century, consequences of which have left deep imprint on the development of the Kosovo's cities life. Another important element in this framework represent especially the albanian uprisings against ottomans during the XVII-XVIII centuries. Uprisings of this time can be considered as expression of albanians displeasure with the tax system and the ill-treatment of turkish administration. The intensity of albanian uprisings was added and intensified even more during these centruies. Among all, the cities of Kaçanik, Prishtina, Prizren and Peja were distinguished. Uprisings had involved notably Kelmend's mountainous lands, lands that lie until Mitrovica and Novi Pazari. Ottoman Empire used different methods to calm the people of Kelmend, making them even some concessions, but it didn't succeed. Even though wars have left huge consequences except Novoberda, a city that was almost entirely destroyed, other cities like Peja, Vuqitërna, Prizreni (administrative center), Prishtina and later on Gjilani and Gjakova, recovered themselves and moved on along other advanced cities of Balkans.

---

<sup>68</sup> Ibid.